

unicef 
per ogni bambino



Finanziato
dall'Unione Europea



MANUAL PËR ORIENTIMIN ARSIMOR DHE PROFESIONAL

PËR TË MITURIT E HUAJ TË PASHOQËRUAR DHE
TË RINJTË MIGRANTË E REFUGJATË NË ITALI





**Finanziato
dall'Unione Europea**

Nën kujdesin e Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale



**MINISTERO del LAVORO
e delle POLITICHE SOCIALI**

Redaktuar nga Zyra Rajonale e UNICEF-it
për Evropën dhe Azinë Qendrore në Itali
(Sarah Martelli, Sophia Benassila, Elena
Locatelli, Ludovica Barbato)

© Fondi i Kombeve të Bashkuara për
Fëmijët (UNICEF), 2024



PËRMBAJTJA

Hyrje	2
Për të miturit e huaj të pashoqëruar	5
1. Çfarë është një rrugë trajnimi?	7
2. Rrugët për arsimin dhe trajnimin në Itali	10
2.1. Nëse je nën 14 vjeç	12
2.2. Nëse je mbi 14 vjeç	13
2.3. Pas marrjes së Dëftesës së shkollës 9-vjeçare “Dëftesë e klasës 9- AMU (Licenza Media)”	14
3. Llojet e rrugëve të trajnimit	16
4. Këshilla për gjetjen e trajnimit dhe të punës	30
5. Kërkesat minimale dhe dokumentet e nevojshme	32
6. Objektivin profesional	35
7. Vlerësimi i aftësive	37
8. T’i përgjigjesh një oferte pune	42
9. Të drejtat e punëtorëve	46
10. Rreziqet e punës pa kontratë	49
11. Parimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit	50
12. Faqe interneti për informacione të mëtejshme	53
Shtojca 1 – Curriculum Vitae “Europass”	55
Shtojca 2 – Tani është radha jote!	61

HYRJE

Tregu i punës po ndryshon vazhdimisht me ritme e më në rritje

Orientimi arsimor dhe profesional është thelbësor në kalimin nga shkolla në botën e punës, sepse i jep mundësi të rinjve të përcaktojnë qëllimet e tyre profesionale dhe lehtëson gjetjen e punës. Për të miturit e huaj të pashoqëruar, orientimi për arsimin dhe karrierën si dhe certifikimet e studimeve janë të rëndësishme:

- Për të ditur se çfarë parashikohet në arsimin dhe trajnimin e detyrueshëm;
- Për të kuptuar sfidat dhe mundësitë e reja në **tregun e punës në Itali**;
- Që t'u **njihen aftësitë dhe kualifikimet** e mëparshme;
- Për të zbuluar aftësitë, **interesat dhe aspiratat e tyre për karrierë**;
- Për të mësuar se cilat **procedura administrative dhe dokumente** nevojiten për të gjetur punë;
- Që të jenë të aftë për të bërë **zgjedhje të mbështetura në informacion për vendin e punës**.



Punëkërkuessit duhet të jenë të vetëdijshëm për aftësitë e reja që janë me doli dhe të kërkuara në botën e punës.

Përveç **aftësive teknike** specifike për çdo sektor, gjithnjë e më shumë vende pune kërkojnë më shumë **aftësi “të tërthorta”** si puna në grup, të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, aftësitë komunikuese dhe negociuese. **Aftësitë digjitale** janë gjithashtu gjithnjë e më të nevojshme, duke marrë parasysh edhe sfidat dhe mundësitë e reja që po shfaqen me inteligjencën artificiale.



Është e rëndësishme të ecësh me ritmin e ndryshimeve më të fundit në botën e punës si dhe me profesionet e reja dhe sektorët në zhvillim.

Për shembull, ndryshimet klimatike kanë theksuar gjithnjë e më shumë nevojën për të investuar më shumë në të ashtuquajturat “**aftësi të gjelbra**” - grup njohurish, aftësish, vlerash dhe qëndrimesh të nevojshme për të jetuar, zhvilluar dhe mbështetur një shoqëri të qëndrueshme nga ana ekologjike. Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), deri në vitin 2030 **tranzicioni i gjelbër** do të çojë në krijimin e 8.4 milionë vendeve të punës në mbarë botën (**punë të gjelbra**) (p.sh. instalues të paneleve diellore, ekspertë në menaxhimin dhe riciklimin e mbetjeve, kuzhinierë të specializuar në gatimin pa asnjë mbetje, agjentë të komunikimit dhe marketingut të gjelbër etj.).



Është e rëndësishme të vlerësohen aftësitë e fituara në të kaluarën dhe kualifikimet e marra në vendin e origjinës.

Njohja si të konvertohen kualifikimet e mëparshme dhe si të përmirësohen aftësitë e fituara përpara mbërritjes në Itali është thelbësore për të shmangur **humbjen e kohës së çmuar dhe për t’u qasur më shpejt në kurset e arsimit të lartë ose në punësim.**

Çfarë është Manuali për Orientimin Arsimor dhe Profesional?

Ky është një udhëzues për aksesin në mundësitë e trajnimit që synojnë arsimimin e vazhdueshëm dhe lehtësimin e gjetjes së punës. Ai synon t’u ofrojë udhëzime të miturve dhe të rinjve migrantë dhe refugjatë që kanë mbërritur vetëm në Itali për t’u futur në tregun e punës.

Kujt i drejtohet?

- Të miturve të huaj të pashoqëruar si dhe të rinjve migrantë dhe refugjatë në Itali;
- Kujdestarëve vullnetarë, operatorëve në strukturat e imigrantëve, mësuesve dhe të gjithë figurave përkatëse në moshë madhore.

Ç'qëllime ka?

- Të japë informacion të dobishëm për qasjen në **rrugët e arsimit dhe trajnimit**, të cilat synojnë vazhdimin e arsimit dhe/ose lehtësimin e gjetjes së punës;
- Të ofrojë udhëzime për mënyrën si vlerësohen **aftësitë** e dikujt dhe për përcaktimin e **synimit profesional të një individi**;
- Të përshkruajë **kërkesat dhe dokumentet minimale** që nevojiten për të kërkuar dhe për të gjetur punë të rregullt në Itali;
- Të japë këshilla të dobishme për **përgatitjen e CV-së dhe për aplikimin për një vend pune**.
- Të rrisë ndërgjegjësimin për **të drejtat e punëtorëve** dhe për **rreziqet e punës pa kontratë**.

Lutemi vini re

Në Vademecum, disa shprehje zyrtare të lidhura me shkollën thjeshtohen duke përdorur terminologji të shkurtuar sepse janë zakonisht më të përsëritura dhe kuptohen nga të rinjtë ose për shkak të hapësirës në seksionet më skematike. Më poshtë janë disa shembuj:

- Shkollë e mesme e ulët: “Shkollë 9-vjeçare”
- Shkollë e mesme e lartë: “Shkollë e mesme”
- Diplomë përmbyllëse e ciklit të parë të arsimit: “Dëftesë e klasës 9-AMU (Licenza Media)”
- Diplomë përmbyllëse e ciklit të dytë të arsimit: “Dëftesë e shkollës së mesme”



PËR TË MITURIT E HUAJ TË PASHOQËRUAR



Pse më duhet Udhëzuesi për Orientimin Profesional?

Nëse je i mitur i huaj i pashoqëruar ose një i ri migrant ose refugjat dhe je në një strukturë pritëse, ky udhëzues do të të ndihmojë të kuptosh “**si të orientoresh**” në tregun e punës dhe t’i hysh rrugës së trajnimeve për pozicione pune.

Pse nuk mund të punoj menjëherë?



Në Itali, si i mitur mund të punosh vetëm nëse:

- je **16 vjeç** *
- Ke ndjekur arsimin e detyrueshëm ose ke përfunduar të paktën dy vjet praktikë profesionale

Pra, nëse je nën 14 vjeç, duhet të regjistrohesh në një shkollë publike, të marrësh “Dëftesën e klasës 9-AMU (Licenza Media)” dhe më pas të regjistrohesh në dy vitet e para të “shkollës së mesme” deri në moshën 16-vjeçare. Nëse, nga ana tjetër, je midis moshës 16 dhe 17 vjeç dhe nuk ke “Dëftesën e klasës 9-AMU”, prapë nuk mund të punosh, por mund të regjistrohesh në një “shkollë të mesme” ose në një shkollë për të rikuperuar vitet e shkollës (CPIA).

* Në Itali, mund të punësohesh edhe nëse je **15 vjeç**, kur hyn në veprim kursi i trajnimit nëpërmjet kontratës së **praktikës profesionale** (Dekreti Legjislativ 81/2015, neni. 43).



**Pse është i rëndësishëm
një kurs trajnimi për të
gjetur punë?**

Kurset e trajnimit të japin mundësinë të **mësosh në vendin e punës** dhe të zhvillosh aftësitë - **aftësitë e forta dhe aftësitë e buta** - që i nevojiten botës së sotme të biznesit. Përveç kësaj, ato të japin mundësinë të marrësh një dokument (zakonisht i quajtur **Attestato**), i cili vërteton aktivitetet që ke kryer dhe aftësitë që ke fituar. Kjo do të ta bëjë më të lehtë **kërkimin dhe gjetjen e punës!**



**Si mund të gjej rrugën më
të përshtatshme për**

Ekzistojnë **lloje të ndryshme kursesh trajnimi** dhe kursesh të orientimit në karrierë. Është e rëndësishme të mos nxitohesh për të mbledhur të gjitha informacionet **që të nevojiten në mënyrë që zgjedhjet e tua të jenë të bazuara në informacion.**

...”Mund të fillosh” nga ky Udhëzues!

Këtu do të gjesh detaje për rrugën që të përshtatet, dokumentet që të nevojiten dhe kë të kontaktosh për mbështetje të drejtpërdrejtë.

Lexim të këndshëm!

1. ÇFARË ËSHTË NJË RRUGË TRAJNIMI?

Një **rrugë trajnimi** është si një rrugë që duhet ndjekur nga një **pikë nisjeje** deri në një **pikë mbërritjeje**.



Pika e nisjes është:

- gjithçka që di, kualifikimet dhe aftësitë që ke fituar deri tani;
- përvojat që ke pasur deri tani;
- karakteristikat e tua personale;
- dëshirat e tua.



Rruga përpara përcaktohet nga:

- të gjitha aktivitetet që do të kryesh;
- gjithçka që do të mësosh;
- gjithçka që do të jetë në dobi të arritjes së qëllimit tënd.



Pika përfundimtare përcaktohet nga:

- njohuritë, aftësitë dhe përvojat e reja të fituara;
- vetëdija për përgatitjen tënde;
- kërkimi i një pune dhe rrjedhimisht hyrja në botën e punës.

Në këtë fazë do të duhet **të vlerësosh dhe çmosh aftësitë** dhe karakteristikat e tua personale.

Do të të duhet të mendosh me kujdes për llojin e punës që dëshiron, atë që dëshiron të bësh ose atë që tashmë di të bësh.

PIKËNISJA

Këto rrugë janë të dobishme sepse do të të japin **udhëzim dhe trajnim për karrierën** si dhe do të të mësojnë për një profesion.

Përdore këtë kohë trajnimi për të kuptuar nëse rruga ose puna që ke zgjedhur të bësh është e duhura për ty.

Shkolla - CPIA

Kurse trajnimi

Praktika
profesionale

Stazhi

Në këtë fazë do të fillosh **kërkimin aktual të punës**. Do të përdorësh një mjet të quajtur Curriculum Vitae për t'i treguar të tjerëve se kush je. Do të duhet të dish si të zgjedhësh ofertat e duhura të punës.

PINKA



LUTEMI VINI RE



Angazhohuni për të zgjedhur rrugën që dëshironi të ndiqni.

Merrni gjithë kohën që ju nevojitet!

*Nëse tashmë keni zgjedhur një rrugë trajnimi dhe mendoni se keni bërë zgjedhjen e gabuar, mos u shqetësoni... **Flisni me kujdestarin, edukatorin ose koordinatorin e qendrës së pritjes dhe kërkonj që t'ju lejohet të rishikoni zgjedhjet tuaja.***

2. RRUGËT PËR ARSIMIN DHE TRAJNIMIN NË ITALI

Arsimi është një e drejtë dhe detyrë themelore e çdo individi deri në moshën 18 vjeç.

- Kjo është një E **DREJTË** sepse është thelbësore për **rritjen personale**, gjetjen e punës dhe **përfshirjen në shoqëri**
- Është **DETYRIM** sepse **të gjithë duhet të kryejnë arsimin dhe trajnimin e detyrueshëm për të hyrë në tregun e punës**

E DREJTA PËR ARSIM

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (Neni 26)
- Konventa e OKB-së “Për të drejtat e fëmijës” (Neni 28)
- Kushtetuta e Italisë (Neni 34)
- Ligji “Zampa” për mbrojtjen e të miturve të huaj të pashoqëruar (neni 14)

Regjistrimi në shkollë është **i detyrueshëm** për të gjithë të miturit nga mosha 6 deri në 16 vjeç, është pa pagesë dhe mund të bëhet në çdo kohë të vitit, edhe ***kur dokumentacioni është i paplotë ose mungon fare!***



Për regjistrimin në shkollë, këtu më poshtë do të lexosh disa informacione të rëndësishme:

1

Shkollën më të afërt mund ta gjesht në faqen e internetit
“Scuola in Chiaro”
<https://cercalatuascuola.istruzione.it/cercalatuascuola/>

2

Regjistrimi në shkollë është **pa pagesë**

3

Mund të regjistrohesh nga **interneti** ose direkt **te shkolla**

4

Mund të regjistrohesh **gjatë gjithë vitit**

5

Mund të regjistrohesh edhe nëse **dokumentet** e tua janë **të paplota** ose **mungojnë fare**

6

Do të regjistrohesh në klasën që **përkon me moshën tënde** ose, në varësi të aftësive të tua, një klasë më lart ose më poshtë

7

Nëse i ke këto dokumente, silli me vete për regjistrimin (përndryshe nuk është problem):
kartën e identitetit; lejen e qëndrimit ose mandatin e kërkesës për leje qëndrimi; dëftesat e studimeve jashtë vendit

8

Njohjen e studimeve jashtë vendit mund ta bësh në dy mënyra:
me një “deklaratë vlefshmërie” ose një vlerësimi të aftësive të lëshuar nga shkolla

2.1. NËSE JE NËN 14 VJEÇ

Nëse je nën 14 vjeç, mund të regjistrohesh në **shkollën 9-vjeçare** e cila në italisht quhet (“scuola media”) ku mund të merrni një dëftesë të shkollës 9-vjeçare që në italisht quhet (“Licenza Media”).

- Shkolla 9-vjeçare zgjat tre vjet dhe është e detyrueshme.
- Përveç lëndëve të mësuara, mund të ndjekësh kurse mbështetëse për të mësuar gjuhën italiane
- Në disa shkolla ka edhe kurs muzike
- Për të gjetur shkollën më të afërt, shko në faqen <https://cercalatuascuola.istruzione.it/cercalatuascuola/>

Lëndët e studiuara në shkollën 9-vjeçare¹



Italisht



Shkencë



Anglisht dhe gjuhë e dytë e huaj



Muzikë



Histori



Edukim artistik



Gjeografi



Edukim fizik



Matematikë



Teknologji

Për më shumë detaje pas “dëftesës së shkollës 9-vjeçare”, shko më poshtë në seksionin 2.3.

¹ <https://unica.istruzione.gov.it/it/orientamento/guida-alla-scelta/dal-sistema-integrato-0-6-anni-al-secondo-ciclo-di-istruzione/scuola-secondaria-di-primo-grado>

2.2. NËSE JE MBI 14 VJEÇ

Nëse je mbi 14 vjeç dhe nuk ke marrë “licenza media”, mund të regjistrohesh në një **CPIA ose Centro Provinciale per l’Istruzione degli Adulti** (“Qendra Rajonale e Arsimit për të Rriturit”).

- CPIA-të ofrojnë kurse të ndryshme ku mund të **mësosh Italisht dhe aftësitë bazë që** të duhen për të hyrë në botën e punës.
- Në shkollë, mund të kërkossh krijimin e PIE-së tënde **ose me emrin e plotë në italisht Piano Educativo Individualizzato** (“Plan Arsimi Individual”) bazuar në nevojat e tua për trajnim.
- Për të gjetur **CPIA-në më të afërt**, ndiq lidhjen me poshtë dhe shkruaj “CPIA” + emrin e qytetit ku jetoni
<https://cercalatuascuola.istruzione.it/cercalatuascuola/>

Kurset arsimore të ofruara nga CPIA-ja ²	
KURSI	PËRSHKRIMI
Niveli i parë Periodha e parë didaktike (400 orë)	Rruga për marrjen e kualifikimit përfundimtar të ciklit të parë të arsimit 9-vjeçar (Licenza Media).
Niveli i parë Periodha e dytë didaktike (825 orë)	Rruga për marrjen e një dëshmie që vërteton përvetësimin e aftësive bazë në lidhje me kurset e përgjithshme të përbashkëta për të gjitha kurset e instituteve profesionale dhe teknike.
Kurs për gjuhën italiane dhe letërsinë (180 orë)	Kurs për njohjen e gjuhës italiane për shtetas të huaj me nivel bazë të italishtes (A1-A2).
Rrugët e përmirësimit të aftësive (200 orë)	Trajnime për të kapur njohuritë dhe aftësitë në fund të shkollës së mesme të ulët (scuola secondaria di primo grado).
Rrugët modulare	Rrugë të shkurtra modulare në fillim të çdo viti shkollor (gjuhët, TIK, etj.).

² CeSPI, Observatori Kombëtar për të Miturit e Huaj të Pashoqëruar në Itali, Raporti i parë 2020.
https://miur.gov.it/documents/20182/0/Rapporto_MSNA_2020.pdf/55d13f7c-66ac-701d-e75c-d43ee296cf3d?t=1616520134774

2.3. PAS MARRJES SË DËFTESËS SË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “LICENZA MEDIA”

Pas marrjes së “Licenza Media” ka dy rrugë të mundshme:

1

Ndiq një rrugë trajnimi profesional

(Arsimi dhe Trajnimi Profesional - ATP)

Ju mund të zgjidhni ndërmjet:

- Kurs 3-vjeçar ose 4-vjeçar në Arsimin dhe Trajnimin Profesional (ATP)
- Praktikë profesionale 3-vjeçare

Pas 3 vitesh merr **kualifikimin profesional**

Pas 4 vitesh merr **diplomën profesionale**

2

Vazhdon studimet në shkollën e mesme

(Scuola Superiore)

Ju mund të zgjidhni ndërmjet:

- Shkollës së mesme
- Institutit Teknik
- Institutit Profesional

Pas 5 vitesh, do të marrësh **diplomën e shkollës së mesme**



**QUALIFICA PROFESSIONALE
(KUALIFIKIM PROFESIONAL)**

**DIPLOMA PROFESSIONALE
(DIPLOMË PROFESIONALE)**

**DIPLOMA DI MATURITÀ
(DIPLOMË E MATURËS)**

Pas marrjes së diplomës ose kualifikimit, hapen 2 rrugë të tjera

1

Rrugët drejt vendit të punës

Për shembull:

- Trajnim në punë (praktikë, stazh, trajnim...)
- Shërbimi Civil (Servizio Civile Universale)
- Kurs i shkurtër profesional

Me përfundimin e këtyre rrugëtimeve merr **certifikata dhe listë notash**.

2

“Universiteti” (Arsimi i lartë)

Ju mund të zgjidhni ndërmjet:

- Universitetit me 3 ose 5 vite
- *Arsimit të Lartë Teknik në italisht “Istruzione Tecnica Superiore”* (ITS) që është arsim teknik i përparuar që zgjat 2 ose 3 vite
- *Arsim dhe Trajtim i Lartë Teknik në italisht “Istruzione e Formazione Tecnica Superiore”* (IFTS) (arsim dhe trajnim teknik përparuar) që zgjat 1 vit

Pas universitetit merr **Diplomë** (diplomë e nivelit “bachelor” ose “master”)

Pas ITS-së ose IFTS-së merr **Certifikatë të Specializimit të Lartë Teknik**



GJETJA E PUNËS

3. LLOJET E RRUGËVE TË TRAJNIMIT

- Ka lloje dhe rrugë të ndryshme trajnimi.
- Para se të zgjedhësh të duhurin, është e rëndësishme të kuptosh dallimet.
- Kështu do të kuptosh se çfarë të presësh nga çdo rrugë dhe çfarë lloj synimesh do të arrish me përfundimin e tyre.

Rrugët e Arsimit dhe Trajnimit Profesional (Istruzione e Formazione Professionale)

Cilat janë rrugët e ATP-së? Rrugët e ATP-së janë kurse profesionale që synojnë të trajnojnë studentët në mënyrë profesionale dhe më pas t'i integrojnë shpejt ata në tregun e punës. Kurset ATP mbikëqyren nga Rajonet dhe Krahinat Autonome, të cilat lëshojnë thirrje publike për financimin e kurseve të ofruara nga strukturat e akredituara të trajnimit.

Vendndodhja: kurset mund të mbahen në qendrat e trajnimit profesional të quajtur **Centri di Formazione Professionale** (CFP) të akredituara nga Rajonet ose në **Istituti Professionali di Stato** (Institutet Profesionale Shtetërore) në bazë të subsidiaritetit.

Kohëzgjatja: 3 ose 4 vjet. Pas dy viteve të para, studenti mund të aplikojë për një certifikatë të aftësive bazë të fituara. Pas vitit të tretë, ata marrin certifikatën e kualifikimit profesional dhe mund të kërkojnë punë. Vetëm disa kurse kanë një vit të katërt, i cili përdoret për të marrë një certifikatë që quhet diplomë profesionale (më e lartë se kualifikimi i arritur në vitin e tretë).

Kualifikimi: 3 vjeçar > **certifikata Kualifikim Profesional** (*Qualifica Professionale*)

4 vjeçar > **certifikata *Diplomë Professionale***
(*Diploma Professionale*)

Shpërblimi: ofrohen kuponë trajnimi për të mbuluar koston e kursit.

Për më shumë informacion: ndiqni lidhjen më poshtë dhe shkruani “centro di formazione professionale” + emrin e rajonit ku jetoni.
<https://cercalatuascuola.istruzione.it/cercalatuascuola>



- Kurset ATP inkurajojnë studentët të mësojnë përmes aktiviteteve praktike. Ato përfshijnë **disa ushtrime praktike dhe aktivitete punëtorie**.
- Certifikatat profesionale të ATP-së (*qualifica* dhe *diploma*) **njihen në nivel kombëtar dhe evropian**.
- Nëse dëshiron, mund të kryesh edhe **vitin e 5-të (me zgjedhje)** në një shkollë të mesme (*secondaria di secondo grado*), në fund të së cilës merr certifikatën shtetërore Diploma e Maturës Shtetërore (*Diploma di Stato -Maturità*).

Stazhi / gjetja e vendit të punës

Çfarë është stazhi/gjetja e vendit të punës: stazhi është periudhë orientimi dhe trajnimi e kryer në një kontekst pune, me synimin për ta futur stazhierin në botën e punës. **Kjo nuk është marrëdhënie pune, por një rrugë që synon ndërthurjen e të mësuarit me përvojën e punës.** Stazhi mund të jetë brenda programit **shkollor** (pjesë e kurrikulës së rrugës tënde të studimit), ose **jashtë programit shkollor** (fillon vetëm pasi të keni përfunduar studimet).

Për të hyrë në një praktikë jashtë shkollës, kërkohet një marrëveshje midis promovuesit dhe pritësit.

- **Promovues:** qendrat e punësimit, agjencitë e punësimit, qendrat e trajnimit, subjektet e trajnimit publik dhe privat, shoqatat, organizatat jofitimprurëse, subjektet e trajnimit profesional, etj. Duke kontaktuar këto organizata, mund të marrësh një listë të përditësuar të mundësive të stazhit në zonën ku jeton. Gjatë fazave fillestare të stazhit, këto subjekte përqendrohen në **çertifikimin e aftësive** dhe përpiqen të gjejnë një **shoqëri tregtare** ose **pritësin tjetër më të përshtatshëm**.
- **Pritësi:** shoqëri tregtare, studime profesionale, dyqane, kooperativa etj. Të gjitha subjektet në të cilat mund të kryesh praktikën. Listën e shoqërive të akredituara mund ta marrësh duke kontaktuar promovuesit.

Kohëzgjatja: e ndryshueshme (minimumi 2 muaj, maksimumi 12 muaj).

Kualifikimi: çertifikim dhe një program trajnimi.

Paga: stazhi jashtëshkollor duhet të përfshijë një pagesë minimale prej 300 euro, e cila mund të rritet në varësi të Rajonit në të cilin jetoni.

Për më shumë informacion: Qendrat e punësimit, agjencitë e punësimit, subjektet publike dhe private dhe qendrat e trajnimit dhe/ose orientimit profesional, institutet profesionale, shoqatat dhe organizatat jofitimprurëse.



- Gjatë praktikës do të të caktohet një person **që do të të drejtojë** gjatë fazave të trajnimit dhe punës.
- Hartohet **programi i trajnimit** për të përcaktuar **të drejtat dhe detyrimet** përkatëse.
- Do të trajnohesh **direkt në vendin tënd të punës**, duke pasuruar **njohuritë** e tua.
- Kjo rrugë ndihmon **angazhimin e drejtpërdrejtë me punën ose profesionin**.
- Kjo gjë të ndihmon të **orientohesh në zgjedhjet e karrierës** tënde.

Rrugët e trajnimit që ofrojnë “Borsa Lavoro”

Çfarë është bursa lavoro (bursa e punës) “Borsa lavoro” është një mjet trajnimi që, nëpërmjet përvojës praktike, synon të ndihmojë futjen në tregun e punës të të ashtuquajturave “grup vulnerabël”, duke u ofruar atyre një bursë (d.m.th. pagesë) në këmbim të pjesëmarrjes së tyre. Një “borsista” ose bursist paguhet nga subjekti që ofron bursën e punës (jo nga kompania ose subjekti ku është fituar përvoja e punës).

Promovuesi: Rajoni, Bashkia apo subjekte të tjera publike (fondacione, shoqata bamirësie, kooperativa sociale etj.).

Kohëzgjatja: e ndryshueshme (minimumi 2 muaj).

Kualifikimi: çertifikim dhe përvojë pune.

Paga: bursa lavoro (e ndryshueshme). Nuk është menduar si rrogë, por si njohje e përkushtimit të bursistit për t’u integruar në mjedisin e punës dhe për detyrat që kryen.

Për më shumë informacion: Qendrat e punësimit, agjencitë e punësimit, subjektet publike dhe private dhe qendrat e trajnimit dhe/ose orientimit profesional, institutet profesionale, shoqatat dhe organizatat jofitimprurëse.



- Është një vend pune me **program zyrtar trajnimi**.
- Do të të caktohet **një person që do të të drejtojë** gjatë periudhës së trajnimit.
- Kjo rrugë ndihmon **angazhimin e drejtpërdrejtë me punën ose profesionin**.

Rrugë trajnimi me praktikë

Çfarë është një praktikë pune: është kontratë pune e karakterizuar nga përmbajtje arsimore, e cila mbështet të rinjtë nga mosha 15 deri në 29 vjeç, në varësi të llojit të praktikës, për të hyrë në tregun e punës. Punëdhënësi, përveçse t'i paguajë praktikantit **shpërblim** për punën e bërë, është i detyruar t'i sigurojë atij **trajnimin e nevojshëm për fitimin e kompetencave të duhura profesionale për rolin dhe detyrat që i ngarkohen**. Praktikanti është i detyruar të ndjekë një kurs trajnimi, që mund të kryhet brenda ose jashtë kompanisë. Ekzistojnë lloje të ndryshme praktikash (të nivelit të parë, të dytë dhe të tretë).

Praktika e nivelit të parë është kontratë pune që lehtëson përfshirjen e të rinjve 15-25 vjeç në tregun e punës, nëpërmjet përvetësimit të diplomës dhe aftësive profesionale. Ajo bën të mundur përmbushjen e shkollimit të detyrueshëm dhe marrjen e diplomës së shkollës së mesme, kualifikimit/ diplomës profesionale ose çertifikatës së specializimit të lartë teknik.

Kohëzgjatja: **Minimumi 6 muaj. Maksimumi: 3 vjet** për kualifikimin profesional; **4 vjet** për diplomën profesionale ose diplomën e shkollës së mesme. Kohëzgjatja mund të zgjasë **1 vit** për ata që tashmë kanë kualifikimin profesional dhe dëshirojnë të marrin diplomën profesionale ose çertifikatën e specializimit të lartë teknik.

Kualifikimi: me praktikën e nivelit të parë, merr kualifikimin/diplomën profesionale, ose diplomën e arsimit të mesëm, ose çertifikatën e specializimit të lartë teknik (IFTS).

Paga: pagë mujore. Për praktikën e nivelit të parë, shpërblimi është 2000 euro në vit për të miturit dhe 3000 euro për të rinjtë mbi 18 vjeç.

Për më shumë informacion: kompanitë që ofrojnë të punësojnë praktikantë. Mund të merrni informacion edhe nga qendrat e punësimit, agjencitë e punës, entet publike dhe private dhe qendrat e trajnimit dhe/

ose orientimit profesional. Pyet ata nëse kanë informacion të përditësuar mbi mundësitë e praktikës në kompani ose organe të tjera në zonën e tyre.



- Përfshin **kontratë** me shkrim, **periudhë prove** dhe një PFI ose **Piano Formativo Individuale** (Plan Individual Trajnimi).
- **Në përfundim të praktikës**, punëdhënësi mund të vendosë nëse do të vazhdojë me kontratë të përhershme pune apo të tërhiqet nga kontrata e praktikës.

Servizio Civile Universale (shërbimi civil universal)

Çfarë është shërbimi civil? Është vendim vullnetar për t'i kushtuar disa muaj të jetës suaj mbrojtjes së paarmatosur dhe jo të dhunshme të vendit, paqes mes njerëzve dhe **promovimit të vlerave themelore për Republikën e Italisë**, duke u angazhuar në aksione për komunitetin dhe për territorin. Të bëhesh **vullnetar i shërbimit civil** është një mundësi **për t'u rritur si person dhe për t'u trajnuar**. Kjo është arsyeja pse mund të jetë e dobishme kryerja e shërbimit civil universal në një mjedis pune.

Kërkesat: kërkuessit duhet të kenë leje qëndrimi të vlefshme në Itali dhe të jenë të moshës nga 18 deri në 28 vjeç.

Procedura: çdo vit, qeveria italiane shpall një **bando (thirrje për aplikime) për të përzgjedhur vullnetarët** që do të angazhohen në programet e Shërbimit Universal Civil (për shembull, në 2022 ata shpallën një *bando* duke kërkuar për më shumë se 56 000 vullnetarë). Çdo *bando* paraqet **programe të ndryshme të propozuara nga organe të ndryshme**.

Nëse je i interesuar, mund të aplikosh brenda afatit të përcaktuar në *bando*:

1. Shko tek <https://www.politichegiovanili.gov.it/servizio-civile/bandi-e-avvisi-di-servizio-civile/> ;
2. Lexo *bando*-n **me kujdes**;
3. **Zgjidh programin** që i përshtatet më së miri interesave dhe pritshmërive që ke;

4. Mund ta bësh aplikimin përmes platformës në internet **DOL**:
www.domandaonline.serviziocivile.it ;
5. Për të hyrë të nevojitet një identitet dixhital **SPID**:
<https://www.spid.gov.it/> ;
6. Nëse je përzgjedhur paraprakisht, subjekti që drejton projektin do të të thërrasë për një **intervistë përzgjedhëse**;
7. Nëse përzgjidhesh, do të bëhesh **punonjës vullnetar i shërbimit civil** dhe do të nënshkruash kontratë me “*Dipartimento per le Politiche Giovanili e il Servizio Civile Universale della Presidenza del Consiglio dei Ministri*” (Departamenti Italian i Këshillit të Ministrave për Politikat Rinore dhe Shërbimin Civil Universal).

Kohëzgjatja: nga 8 deri në 12 muaj, në varësi të programit. Ngarkesa javore e punës është të paktën 25 orë ose orët totale vjetore janë midis 1145 orë për programet që zgjasin 12 muaj dhe 765 orë për projektet që zgjasin 8 muaj.

Kualifikimet: kredite trajnimi dhe çertifikim i pjesëmarrjes në shërbimin civil.

Pagesa: parashikohet një pagesë mujore.

Më shumë informacion: mund të gjesh detaje mbi përgjigjen ndaj një thirrjeje për aplikime për të marrë pjesë në shërbimin civil universal në faqen e internetit të *Dipartimento per le Politiche Giovanili e il Servizio Civile Universale*:
<https://www.politichegiovanili.gov.it/servizio-civile/cosa-e-il-servizio-civile/>



- Në disa programe **preferohen të rinjtë me më pak mundësi**.
- Për disa programe është e mundur të aktivizohet një **periudhë tutoriale (që zgjat deri në tre muaj)** për të lehtësuar përfshirjen tënde në mjedisin e punës.
- Për të pasur **një ide se si përgatitet një bando dhe si të përgjigjesh**, shih publikimin e vitit 2024:
<https://www.scelgoilserviziocivile.gov.it/leggi-il-bando/il-testo/>

Çertifikime dhe kurse profesionale afatshkurtra

Përveç alternativave të sipërpërmendura, ekziston një gamë e gjerë **kursesh afatshkurtra që ju lejojnë të specializoheni në profesione të veçanta**. Detajet në lidhje me ato kurse (kohëzgjatja, kërkesat, mundësitë e punësimit, etj.) ndryshojnë shumë në varësi të sektorit të punës në fjalë dhe llojit të kualifikimit ose çertifikimit që dëshiron të marrësh. Kurset e specializimit organizohen përgjithësisht nga subjekte vendore publike, private ose nga sektori i tretë.

Prandaj, është e rëndësishme të mësosh për mundësitë e disponueshme në Rajonin ose Provincën në të cilën jeton.

Disa shembuj: më poshtë janë tre shembuj të profesioneve dhe kualifikimeve të cilat mund të merren përmes Çertifikime profesionale dhe kurseve afatshkurtra.

Ndërmjetësues gjuhësor dhe kulturor: Një rol shumë i kërkuar, në menaxhimin e proceseve delikate **të komunikimit dhe marrëdhënieve me të huajt**, për t'i mbështetur ata në qasjen në informacionin kyç, shërbimet publike dhe private dhe për të mbështetur integrimin e tyre në sistemet e arsimit, punës, shëndetësisë etj. Kur bëhesh ndërmjetës gjuhësor dhe kulturor, mund të punosh në kontekste të ndryshme: struktura kujdesi, komisarate policie, prefektura, qendra punësimi, shkolla, mjedise sociale dhe shëndetësore dhe njësi të tjera që ofrojnë shërbime personale.

Për më shumë informacion: <https://www.integrazionemigranti.gov.it/it-it/Dettaglio-approfondimento/id/41/Mediazione-interculturale>



Certifikata HACCP: HACCP do të thotë Analiza e Rreziqeve dhe e Pikave Kritike të Kontrollit. Kjo çertifikatë është **e detyrueshme për personat që synojnë të punojnë në industrinë ushqimore** dhe që do të kenë kontakt me ushqimin. Nëse dëshiron të bëhesh kuzhinier, ndihmës kuzhinier ose kamerier, apo edhe shitës ushqimesh (etj.), do të të duhet të përfundosh një kurs dhe të marrësh një certifikatë HACCP, e cila konfirmon njohuritë dhe kompetencat e tua në lidhje me procedurat për të garantuar **sigurinë higjienike të ushqimit**.

Për më shumë informacion: https://www.salute.gov.it/portale/temi/p2_6.jsp?id=1225&area=sicurezzaAlimentare&menu=igiene

Operatore Socio-Sanitario (OSS) - punonjës i mbështetjes sociale dhe shëndetësore: Është dikush që angazhohet në aktivitete që kanë të bëjnë me **kujdesin dhe ofrimin e ndihmës për personat me aftësi të kufizuara ose që nuk janë të vetëmjaftueshëm fizikisht dhe/ose mendërisht**, duke punuar me OSS të tjerë. Prandaj, programi OSS favorizon mirëqenien e përdoruesit të shërbimit, autonominë e tij dhe përfshirjen sociale në mjedise të ndryshme pune: spitale, shtëpi të të moshuarve, azile si dhe njësi që ofrojnë shërbime shëndetësore dhe shoqërore/shërbime sociale qofshin ato publike apo edhe dhe private.

Për më shumë informacion: <https://www.salute.gov.it/portale/moduliServizi/dettaglioSchedaModuliServizi.jsp?lingua=italiano&label=servizionline&idMat=PROFS&idAmb=RTENC&idSrv=D2.26&flag=P>

Kualifikim si operator i IT-së: ky është dikush me **aftësi IT** i specializuar në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit dhe që punon veçanërisht në instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e harduerit dhe softuerit për kompjuter, telefona celulare, rrjete, serverë, etj. Ky kualifikim mundëson qasjen në mjedise të ndryshme pune, duke përfshirë departamentet e IT-së në kompani, ente publike, shkolla dhe në qendrat e kompanive të ndryshme për ndihmën ndaj klientit.

Për më shumë informacion: https://www.anpal.gov.it/notizie/-/asset_publisher/Yfaaffr5jnf9/content/ict-force-corsi-per-programmatori-web-e-mobile-oriented

...por ka edhe plot të tjera!!!

Shiko kurset profesionale afatshkurtra të ofruara nga Rajoni ose Provinca ku jeton.



SHEMBUJ TË PROJEKTEVE QË MBËSHTETIN GJETJEN E VENDIT TË PUNËS

Programi “PERCORSI 4”: trajnim, punë dhe integrim për migrantët e rinj

Objektivi: të nxitë ndihmën për të miturit e huaj të pashoqëruar dhe të rinjtë imigrantë për të kaluar nga mjedisi i mbrojtur në të cilin ata u pritën drejt pavarësisë dhe integritit të plotë brenda komuniteteve lokale, me anë të **rrugëve të integruara për integrimin social dhe vendosjen në punë nëpërmjet orientimit dhe praktikës**. Projekti mbështetet nga Ministria e Punës dhe Politikave Sociale dhe aktualisht është në fazën e katërt në Basilicata, Calabria, Campania, Puglia dhe Sicilia.

Kohëzgjatja: 6 muaj, me mundësi zgjatjeje deri në 12 muaj.

Paga: pagesë për frekuentimin dhe pagesë individuale, me të cilat mund të kesh qasje në shërbime për të zhvilluar aftësitë e tua, shërbime të integritit social dhe të punësimit dhe ndihmë për arritjen e pavarësisë.

Palët e interesuara në programin e ndihmës individuale:

- **Përfituesit:** për të aplikuar duhet të jesh **midis 16 dhe 24 vjeç**, të jesh i mitur i huaj i pashoqëruar ose i rritur që ka hyrë në Itali si i mitur i huaj i pashoqëruar dhe të jesh i papunë në momentin e aplikimit.
- **Promovuesit:** subjekte publike dhe private të autorizuar për të ndërmjetësuar ose akredituar në ofrimin e shërbimeve të punësimit.
- **Pritësit:** të gjithë punëdhënësit që mund të presin praktikantë.

Më shumë informacion: nëse dëshiron të marrësh pjesë në programin “Percorsi 4”, shko te faqja përkatëse: <https://www.lavoro.gov.it/temi-e-priorita/immigrazione/focus-on/politiche-di-integrazione-sociale/pagine/attivita-e-servizi>

Projekti “PUOI PLUS”

Objektivi: nisma e re “PUOI PLUS”³ synon të ofrojë mbështetje specifike sipas nevojave të shtetasve të vendeve të treta përmes programeve të integritit me fokus këshillimin, edukimin, gjuhën dhe trajnime të tjera, p.sh. kurset e orientimit qytetar dhe profesional.

Objektivat specifike të nismës janë:

- nxitja, menaxhimi dhe monitorimi i rrugëve të tranzicionit drejt punës;
- kualifikimi i rrugës së gjithëpërfshirjes përmes ndihmës dhe shoqërimit të operatorëve të përfshirë, disponueshmërisë dhe ndarjes së metodologjive dhe mjeteve të nismës;
- vlerësimi në aspektin cilësor-sasior të rrugëve të tranzicionit dhe promovimin dhe përhapjen e rezultateve të nismës;
- promovimi i një roli më aktiv të qendrave të punësimit si për të përmbushur nevojat komplekse të imigrantëve, ashtu edhe për të kontribuar në zhvillimin e rrjeteve të reja dhe më të gjera, me lidhje efkase dhe efektive publike-private.

Grupi i synuar: imigrantët e pambrojtur si shtetasit e vendeve të treta me mbrojtje ndërkombëtare, të përkohshme dhe të veçantë, azilkërkuesit, të miturit e pashoqëruar dhe ish të miturit e huaj, viktimat e trafikimit dhe/ose shfrytëzimit të rëndë në punë dhe/ose viktimat e dhunës me bazë gjinore.

Informacion për promovuesit: Nisma do të financohet në mënyrë plotësuese nga AMIF dhe Plani Kombëtar për Gjithëpërfshirjen dhe

³ https://www.interno.gov.it/sites/default/files/2023-12/invito_ad_hoc_puoiplus_fami-signed.pdf

Parandalimin e Varfërisë 2021-27, për të cilën Drejtoria e Përgjithshme për Politikën e Emigracionit dhe Integritetit është identifikuar si organi ndërmjetës, për të propozuar një ofertë më të gjerë dhe shumëvjeçare të ndihmave individuale dhe të forcojë rrugët e integritetit socio-profesionale nën ESF+ për 6200 imigrantë të pambrojtur që janë shtetas të vendeve të treta. Burimet e parashikuara për financimin e projektit arrijnë një maksimum prej 15 000 000 € nga Fondi Italian për Migracionin dhe Integritetin 2021-2027. Drejtoria e Përgjithshme për Politikën e Emigracionit dhe Integritetit rezervon të drejtën të zgjerojë shpërndarjen e financimit të projektit edhe nëpërmjet burimeve të tjera kombëtare dhe/ose të BE-së.

Më shumë informacion: https://www.interno.gov.it/sites/default/files/2023-12/invito_ad_hoc_puoipius_fami-signed.pdf



Seminaret “Skills4YOUth”

Objektivi: seminare për orientimin në punë dhe zhvillimin e aftësive të buta për refugjatët dhe imigrantët e rinj në ambientet e pritjes dhe në shkollat për rikuperimin e viteve të shkollës (CPIA). Nisma Skills4YOUth është promovuar nga UNICEF, në partneritet me Junior Achievement Italy, në kuadër të projektit PROTECT⁴ në bashkëpunim me Komisionin Evropian.

Metodologjia: me seminare Skills4Youth (S4Y), falë **aktiviteteve në grup**, mund të reflektosh mbi **punën që dëshiron të bësh, aftësitë e tua dhe trajnimin** që të nevojitet për t'i zhvilluar ato. Mund të thellosh njohuritë e tua **për të drejtat e punëtorëve** dhe të mësosh si të përgatitësh një **Curriculum Vitae** ose një **intervistë pune**.

Vendndodhja dhe kohëzgjatja: Seminaret S4Y promovohen në strukturat e pritjes dhe në CPIA-të në të gjithë Italinë. Çdo seminar zgjat afërsisht 4 orë.

Kualifikimi: në fund të seminareve secilit pjesëmarrës i jepet një certifikatë pjesëmarrjeje.

Për më shumë informacion: seminare mund të zhvillohen nga stafi i strukturave dhe CPIA-së falë materialit të vënë në dispozicion nga UNICEF-i, ku përfshihet **një kurs e-learning falas** dhe **një Udhëzues Ndhimës** për edukatorët, operatorët, kujdestarët dhe aktorët e sistemit të pritjes. Për më shumë informacion mbi Skills4YOUth: <https://www.unicef.it/media/skills4youth-valorizzare-le-proprie-competenze-per-orientarsi-nel-mondo-del-lavoro-costruire-il-proprio-futuro/>

⁴ <https://www.unicef.it/media/l-unicef-e-la-commissione-europea-rafforzano-la-collaborazione-a-favore-di-bambini-bambine-e-adolescenti-rifugiati-e-migranti-in-italia-protect-protecting-children-on-the-move/>

4. KËSHILLA PËR GJETJEN E TRAJNIMIT DHE TË PUNËS

Ku të gjeni trajnime profesionale dhe mundësi punësimi?

Më poshtë janë disa këshilla!

1

Qendrat e Trajnimit Profesional (Centri di Formazione Professionale, CFP)

- Kurse të Arsimit dhe Trajnimit Profesional (ATP)
- Kurse të shkurtra profesionale, falas dhe me pagesë
- Gjeni CFP-në më të afërt në faqen e internetit Scuola in Chiaro
<https://cercalatuascuola.istruzione.it/cercalatuascuola/>

2

Qendra të Punës (CPI)

- Qendrat i vënë rekrutuesit në kontakt me punëkërkuesit
- Me Deklaratën e Gatishmërisë së Menjëhershme për Punë (DID) ju deklaroni se jeni të gatshëm për punë
- Informacion për mundësitë e punësimit, stazhet, praktikat dhe trajnimin profesional
- Ndihmë për shkrimin e Curriculum Vitae (CV) tënde dhe për dërgimin e një aplikimi
- Shërbimet CPI-ve janë falas
- Gjeni CPI-në më të afërt ‘Seksionin e Kërkimit’ të faqes së Ministrisë së Punës
<https://servizi.lavoro.gov.it/cerca-sportello/>

3

Pika e informacionit “Informagiovani” pranë Bashkisë ku banon

- Informacion për trajnimin profesional dhe punësimin, vullnetarizmin dhe mundësitë për të kaluar kohën e lirë
- Gjej pikën e informacionit “Informagiovani” më afër teje duke shkruar “Cerca Sportello” në faqen e Ministrisë së Punës <https://servizi.lavoro.gov.it/cerca-sportello/>

4

Faqja e internetit e Rajonit ku jeton

- Shkruaj ‘Lavoro + Emri i Rajonit’ në internet, p.sh. ‘Lavoro Regione Toscana’.
- Gjej faqen kushtuar mundësive të punësimit dhe kurset e shkurtra profesionale në rajon (disa janë falas!)

*Mbaj gjithmonë parasysh se **personeli i qendrës së pritjes dhe kujdestari yt mund të të ndihmojnë të zgjedhësh një nga rrugët e përshkruara më sipër! Mos hezito të flasësh me ta për gjërat që preferon dhe t'i pyesësh për këshilla.***

Ky udhëzues të jep këshilla praktike si t'i hedhësh vetë hapat e para, por personeli i qendrës së pritjes dhe kujdestari yt janë figurat më të rëndësishme për ty deri në moshën 18 vjeç.



5. KËRKESAT MINIMALE DHE DOKUMENTET E NEVOJSHME

KËRKESAT MINIMALE: cilësitë, kushtet ose karakteristikat që kërkohen përpara se të hyni në një trajnim. Kërkesat ndryshojnë nga trajnimi në trajnim, megjithatë kërkesat bazë të zbatueshme për të gjitha trajnimet janë renditur më poshtë.

Për të filluar një trajnim dhe për të punuar në Itali, të duhet...

1

Të jesh të paktën 16 vjeç*

Në Itali, duhet të jesh të paktën 16 vjeç për të filluar punën, që do të thotë se **nëse je nën 16 vjeç, nuk mund të punosh ende**, por mund të vazhdash shkollën dhe të regjistrohesh në programe trajnimi.*

2

Të banosh ligjërisht në Itali

Kjo do të thotë që ke **leje qëndrimi të vlefshme** (për më shumë shih seksionin për dokumentet e kërkuara).

3

Të kesh jetuar në Itali për të paktën 2-6 muaj

Kjo është periudha minimale për:

- marrjen e Dëftesë e shkollës së Mesme (Licenza Media)
- zhvillimin e njohurive të mjaftueshme të gjuhës italiane
- marrjen e një leje qëndrimi
- Aplikimi për rezidencë

4

Të kesh njohuri të mjaftueshme të gjuhës italiane

Kjo nuk është e detyrueshme... Por kjo nuk do të thotë se nuk është e rëndësishme!

Është **thelbësore për çdo rrugë trajnimi/pune**, por edhe për procesin e përfshirjes tënde në shoqëri.

* Në Itali, mund të punësohesh edhe nëse je **15 vjeç**, kur hyn në veprim kursi i trajnimit nëpërmjet kontratës së **praktikës profesionale** (Dekreti Legjislativ 81/2015, neni. 43).

5

**Ke marrë
“Licenza
Media”
(dëftesa e
shkollës së
mesme)**

Bisedo me kujdestarin tënd ose me një anëtar të stafit në strukturën e pritjes për fillimin e procedurës së **vetë-çertifikimit** për vitet e shkollës së përfunduar dhe **njohjen e kualifikimeve të marra në vendin tënd të origjinës**.

6

**Të jesh i
regjistruar
në Anagrafe
(regjistri
i gjendjes
civile) dhe/ose
rezident në
Itali**

Bisedo me kujdestarin ose anëtarët e stafit të strukturës së pritjes për fillimin e procedurës për dy arsye:

Vendbanimi: vërteton adresën tënde; kjo mund të jetë gjithashtu adresa e një institucioni të kujdesit;
Anagrafe (regjistri i gjendjes civile): vërteton se je i pranishëm në territorin e Italisë. Është gjithashtu e rëndësishme për çështjet e shtetësisë.

DOKUMENTET E KËRKUARA: edhe dokumentet e nevojshme ndryshojnë në varësi të llojit të rrugës së zgjedhur. Sidoqoftë, më poshtë ndodhet një listë e dokumenteve që është mirë të fillosh t’i bësh gati, ose t’i kesh gati, me ndihmën e kujdestarit ose punonjësve të strukturës së pritjes.

1

**Një leje
qëndrimi të
vlefshme**

Nëse nuk i ke këto dokumente, mund të përdorësh edhe një kopje të **Domanda di Protezione Internazionale (C3)** (Kërkesa për Mbrojtje Ndërkombëtare) ose **njoftimin e statusit tënd nga Commissione Territoriale**.

2

**Kartën tënde
të identitetit**

Mund të aplikosh për një kartë identiteti vetëm **pasi të kesh marrë një leje qëndrimi**. Do të duhet të japësh detajet e një ‘**vendbanimi**’: mund të përdorësh adresën e strukturës së pritjes deri në fund të qëndrimit tënd.

3

**Codice Fiscale
(kodi fiskal)**

Kujdestari yt ose një anëtar i stafit në strukturën e pritjes mund të të ndihmojë të marrësh një **kod fiskal** nga agjencia italiane për të ardhurat: *Agenzia delle Entrate*. Sidoqoftë, mund të përdorësh **kodin STP** (STP do të thotë *Straniero Temporaneamente Presente* ose “shtetas i huaj përkohësisht i pranishëm”).

4

**Një kopje e
Licenza Media**

Kjo lëshohet nga shkolla ose shkolla ku rikuperohen vitet e shkollës ose nga CPIA (*Centro Provinciale per l'Istruzione degli Adulti*) që keni ndjekur në fund të kursit.

5

**PIP, PFI ose
PEI**

Ky është dokument **që përdoret për të vendosur objektivat e rrugës së trajnimit që je duke ndjekur, bazuar në nevojat e tua specifike**. Plani përgatitet së bashku me kujdestarin tënd ose një anëtar të stafit në qendrën e pritjes, shkollën ose CPIA-në ose qendrën e punësimit. Me këto shkurtesa kuptojmë:
PIP = Plan i Personalizuar i Ndërhyrjes
PFI = Plan Individual i Trajnimit
PEI = Program Arsimor i Individualizuar

6

**Deklarata e
Gatishmërisë
së
Menjëhershme
për punë**

Mund të dorëzosh DID-në në një qendër punësimi, ku deklaron se je i papunë dhe **i gatshëm për t'u punësuar**. Nëse je i mitur, në qendrën e punësimit duhet të të shoqërojë kujdestari yt ose një anëtar i personelit të qendrës së pritjes.

Dokumentet që duhet të sjellësh në qendrën e punësimit (CPI)

- Kodin fiskal
- *Permesso di soggiorno* (lejen e qëndrimit)
- Njoftimin e kujdestarisë dhe **emërimin e kujdestarit tënd**
- **Autorizimin e kujdestarit tënd** për t'u regjistruar në qendrën e punësimit.
- Prokura e kujdestarit tek operatori shoqërues



6. OBJEKTIVIN PROFESIONAL

Është e rëndësishme të përcaktosh objektivin tënd profesional për të pasur sukses në gjetjen e punës!

Mirë, por çfarë do të thotë saktësisht?



Objektivi yt profesional është një kombinim i aspiratave dhe ambicieve të tua profesionale... Kjo është ajo që dëshiron të bësh kur të rritesh! Është e rëndësishme ta përcaktosh këtë që në fillim:

- Kështu do **ta përcaktosh rrugën për të ardhmen tënde profesionale dhe personale;**
- Është e rëndësishme **për të planifikuar një kurs trajnimi që synon arritjen e objektivit tënd;**
- Do të të ndihmojë të orientosh vendimet e tua në mënyrë që **të gjesh punën më të përshtatshme për profilin dhe interesat e tua!**



Për të përcaktuar objektivat e tua profesionale, **nuk mjafton të mendosh se çfarë dëshiron të bësh...**

Është e rëndësishme **të zbulosh se çfarë ofron tregu i punës** dhe në cilët sektorë kërkesa për punë është më e lartë.

Atëherë mund të mendosh edhe se **çfarë kompetencash të nevojiten** për punën tënde të ëndrrave!



Tani është radha jote!

Më poshtë është një aktivitet i marrë nga rrugëtimi “UPSHIFT” i UNICEF-it dhe JA Italia. Mundohu t’u përgjigjesh pyetjeve dhe mendo për objektivin tënd profesional.

1. KUSH JE TI?

Çfarë të pëlqen të bësh? Çfarë je i zoti të bësh?

.....

.....

Çfarë pëlqejnë të tjerët tek ti?

.....

.....

.....

2. Ç'BËHET?

Në cilin mjedis pune do të kishe qejf të punoje?

.....

.....

Çfarë roli do kishe qejf të kishe?

.....

.....

.....

3. SI TË ARRISH NË ATË ROL?

Çfarë lloj shkolle ose programi trajnimi nevojitet për të marrë këtë punë? Një diplomë? Një diplomë universitare? Një certifikatë për një program trajnimi specifik?

.....

.....

.....

Çfarë aftësish duhet të zhvillosh për të bërë këtë punë?

.....

.....

.....

A njeh dikë që punon në këtë sektor pune? Nëse po, shkruaj emrin e këtij personi. Nëse jo, përpiku të imagjinosh se si mund të viresh në kontakt me dikë që punon në atë sektor. Për çfarë do ta pyesje?

.....

.....

.....

.....

7. VLERËSIMI I AFTËSIVE

Për të ndihmuar në zgjedhjen e një objektivi profesional, mendo për karakteristikat dhe aftësitë e tua personale.

Aftësitë janë të gjitha karakteristikat personale që janë të rëndësishme kur zgjedh dhe kërkon të gjesh rrugën më të përshtatshme të trajnimit për ty:

- **Të gjitha gjërat që mund të bësh,** kapacitetet dhe aftësitë e tua;
- **Aktivitetet në të cilat ke marrë pjesë, përvojat personale;**
- **Interesat dhe pasionet** e tua!



Egzistojnë klasifikime të ndryshme të aftësive. Ja një shembull i llojeve kryesore të aftësive:

AFTËSITË FUNKSIONALE

Aftësitë themelore

Këto janë aftësi themelore, thelbësore për shkrim-leximin individual:

- Të shkruarit
- Të lexuarit
- Të numëruarit

AFTËSITË TEKNIKE

Aftësitë e forta

Këto aftësi varen nga historiku i arsimit dhe aftësitë që lidhen me punë specifike:

- Njohuri teorike (p.sh. në ekonomi, financa...)
- Të gatuarit
- Aftësitë hidraulike
- Gjuhët e huaja
- Përdorimi i makinerive të veçanta...

AFTËSITË DIGJITALE

Aftësitë digjitale

Aftësitë që lidhen me teknologjitë e shoqërisë së informacionit:

- Përdorimi i kompjuterit
- Krijimi i përmbajtjeve dixhitale
- Zhvillimi i softuerit
- Përdorimi i rrjeteve sociale
- Kërkimi i informacionit në internet...

AFTËSITË E TËRTHORTA

Aftësitë e buta

Të njohura gjithashtu si aftësi të shekullit 21 ose aftësi për jetën, këto janë aftësitë socio-emocionale që zbatohen në çdo fushë pune:

- Të punuarit në grup
- Zgjidhja e problemeve
- Marrja e vendimeve
- Komunikimi
- Duke treguar iniciativë
- Krijimtaria dhe risitë
- Të menduarit kritik
- Menaxhimi i stresit
- Empatia...

Është e rëndësishme të vlerësosh aftësitë e tua në mënyrë që të përcaktosh një objektiv profesional dhe të zgjedhësh një rrugë trajnimi.

Vlerësimi i aftësive të tua të bën **të vetëdijshëm për atë që mundesh dhe nuk mundesh (ende) të bësh**, dhe për aftësitë dhe prirjet e tua. Është e rëndësishme për:

- të vërtetuar të gjitha **aftësitë që ekzistojnë më parë** (ato që tashmë i ke pasur);
- të njohur atë **që bën më mirë**;
- identifikuar aftësitë që duhet të përmirësosh.

Pse më duhet të vlerësoj aftësitë e mia?





Mos harro se ndërmarrja e një **vlerësimi real** do të thotë t'i qasesh detyrës në mënyrë kritike. Mendo për aftësitë e tua duke mbajtur parasysh se ato kanë aspekte pozitive dhe negative.



Tani është radha jote!

Më poshtë është një aktivitet i marrë nga UNICEF dhe JA Italia të quajtur 'Crescere Che Impresa!' për nismën UPSHIFT'. Përpiqu t'u përgjigjesh këtyre 10 pyetjeve... Profili yt individual profesional do të krijohet në bazë të përgjigjeve të tua.

ÇFARË NGJYRE JE TI?

Ky test do të të ndihmojë të njohësh më mirë veten.

1. Si i merr vendimet?

- A.** Marr vendime të shpejta dhe i besoj zgjedhjes sime të parë
- B.** I mendoj shumë dhe jam jashtëzakonisht i pavendosur
- C.** Pyes veten se çfarë mund të mendojnë njerëzit e tjerë për zgjedhjen time
- D.** I marr seriozisht dhe përpiqem të marr vendimin më të mirë të mundshëm

2. Cila është mënyra më e mirë me të cilën shokët e tu të tregojnë dashurinë e tyre?

- A.** Duke u argëtuar dhe duke luajtur me mua
- B.** Duke më lejuar të them mendimin tim dhe të jem vetvetja
- C.** Duke kaluar kohë së bashku duke bërë gjithçka
- D.** Duke mbajtur fjalën e tyre dhe duke mos i thyer kurrë premtimet

3. Si sillesh kur je me shokët e tu?

- A.** Unë sjell pasion, lumturi dhe argëtim
- B.** Unë jam i ndershëm dhe jap këshilla
- C.** Unë kujdesem për ta
- D.** Unë planifikoj dhe organizoj daljet tona

4. Çfarë të pëlqen më shumë?

- A.** Argëtimi dhe një jetë pa shqetësime
- B.** Të them dhe të bëj gjithmonë atë që besoj
- C.** Të krijoj harmoni dhe unitet në grup
- D.** Të jem person i përgjegjshëm, i besueshëm, i dobishëm për të tjerët

5. Si do ta përshkruaje veten tënde?

- A.** Trim
- B.** I mendueshëm
- C.** I ndjeshëm
- D.** I organizuar

6. Si do të të përshkruanin shokët që të njohin më mirë?

- A.** Konkurrues
- B.** I rezervuar
- C.** Miqësor
- D.** I rregullt

7. Çfarë bën kur ndihesh i trishtuar dhe i zymtë?

- A.** Bëhem i pasjellshëm dhe gjaknxehtë
- B.** I mbaj gjërat për vete dhe hesht
- C.** Ndjej nevojën të flas me njerëzit më të afërt
- D.** Mundohem të kuptoj pse jam i trishtuar dhe të kërkoj një mënyrë për ta zgjidhur

8. Kur ndihesh mirë me veten?

- A.** Kur arrij të bëj gjëra të vështira
- B.** Kur zgjidh një problem
- C.** Kur ndihmoj të tjerët
- D.** Kur njerëzit më lavdërojnë

9. Kur bën diçka të keqe, ndodh sepse je:

- A.** I pasjellshëm
- B.** Arrogant
- C.** Dikush që i nënshtrohet lehtë presionit të bashkëmoshatarëve
- D.** Bullizues

10. Çfarë do të thoshnin për ty njerëzit që të vlerësojnë?

- A.** Unë jam i pëlqyeshëm, i zgjuar dhe i këndshëm
- B.** Jam reflektues më pëlqen të zgjidh problemet dhe të sugjeroj zgjidhje të vlefshme
- C.** Unë jam miqësor, shkoj mirë me të gjithë dhe jam i disponueshëm për të tjerët
- D.** Jam i rregullt, i organizuar, i përgatitur dhe i kryej detyrat e mia me saktësi

Tani shiko shkronjat pranë përgjigjeve të tua. Cilën shkronjë zgjodhe më shpesh?

A > E VERDHË

Pasionant: frymëzues, i aftë për të krijuar lidhje, stimulues, intuitiv

B > BLU

Racional: i saktë dhe sistematik, kompetent, i aftë për vetëkontroll, i qetë dhe i menduar

C > E GJELBËR

Diplomat: një dëgjues i mirë, i qetë dhe paqësor, mbështetës që projekton harmoni dhe besim

D > E KUQE

Ambicioz: i orientuar për veprim, i pëqendruar te rezultatet, i vendosur, vendimmarrës i shpejtë

8. T'I PËRGJIGJESH NJË OFERTE PUNE

CV-ja: është një dokument që përmbledh një sërë informacionesh rreth teje dhe përdoret për të aplikuar për një vend pune. CV-ja jote përfshin studimet që ke përfunduar, kualifikimet, çdo eksperiencë punë që ke, gjuhët që flet...

Por jo vetëm kaq! Ky dokument gjithashtu shpjegon pak se kush je, cili është objektivi yt profesional, cilat janë aftësitë e tua, cili është stili yt i punës - për shembull, a të pëlqen të punosh në ekip apo preferon të punosh në mënyrë të pavarur - por edhe cilat janë interesat dhe hobet e tua të përditshme, a bën punë bamirësie...

Me pak fjalë, CV-ja është si një kartëvizitë që e përdor për t'u prezantuar me një punëdhënës të mundshëm!

Kur aplikon për një vend pune, menaxheri i burimeve njerëzore përdor CV-në tënde për të vendosur nëse profili yt përputhet me pozicionin në fjalë. Prandaj, CV-ja është zakonisht burimi i parë i informacionit për të vendosur nëse do ta shqyrtojë më tej aplikimin tënd, për shembull me një intervistë.

Edhe për të marrë pjesë në një **kurs trajnimi** të organizuar nga një institucion apo qendër trajnimi, shpesh duhet të dorëzosh CV-në tënde. Pasi të kesh kryer trajnimin, do të jetë e rëndësishme të përfshish të gjitha aftësitë, cilësitë dhe përvojën tënde në këtë dokument.



Ka disa formate që mund të përdorësh për të shkruar CV-në. Një nga format më të kërkuara është formati evropian: **EUROPASS**. Për të filluar krijimin e CV-së EUROPASS në internet, kliko këtu: <https://europa.eu/europass/it> dhe kliko te "Crea un CV".

Në fund të këtij Manuali, do të gjesh shembull të një CV-e në formatin EUROPASS (shih Shtojcën 1). Në këtë shembull, **do të gjesh udhëzime dhe këshilla të shkruara me të kuqe**, të cilat do të të ndihmojnë të plotësosh CV-në tënde. **Megjithatë, këtu janë disa këshilla të përgjithshme.**



Disa këshilla...

Gjatësia: maksimumi 1-2 faqe. Ata që shqyrtojnë CV-të zakonisht nuk kanë shumë kohë: është më mirë të jesh i qartë, por konciz!

Objektivi profesional: në fillim të CV-së, vendos një fjali të shkurtër që tregon objektivin që dëshiron të arrish profesionalisht (shih Kapitullin 5 të këtij Manuali). Mund të jetë qëllimi yt afatshkurtër ose afatgjatë. Nuk është me detyrim ta përfshish, por personi që e lexon do të kuptojë se je menduar mirë për të dhe se ke synime të qarta.

Shembull:

Duke qenë se kam pasion gatimin, do të doja të zhvilloja përvojën dhe aftësitë e nevojshme për t'u bërë një kuzhinier i njohur ndërkombëtarisht.

Nëse nuk e ke ende të qartë qëllimin tënd profesional, mos u shqetëso. Mund të përshkruash personalitetin tënd ose mjedisin në të cilin dëshiron të punosh.

Këtu janë dy shembuj:

1. *Do të doja të punoja në një ekip dinamik, me shumë kultura. Ndërveprimi me personalitete të ndryshme do të më ndihmojë të gjej rrugën drejt karrierës që më përshtatet më së miri dhe të rritem, jo vetëm në nivel profesional, por edhe njerëzor.*
2. *Unë jam person krijues dhe kam nevojë të shpalos idetë e mia!
Do të doja të punoja në një kompani që vlerëson diversitetin si forcë dhe është e hapur ndaj ideve të reja.*

Aftësitë: përpiku të theksosh aftësitë e tua, edhe nëse nuk ke shumë përvojë pune. Po ta mendosh mirë, ka shumë aftësi që i ke dhe i merr si të mirëqena! Për shembull, fakti që ke historik migracioni, që di disa gjuhë dhe kultura të shumta është një burim i kaq shumë aftësive:

- Qëndresë
- Elasticitet
- Empati
- Përshtatshmëri
- Pavarësi
- Aftësi ndërmjetësimi

Kontrolli i fundit: kërkoji një personi të tretë (kujdestarit tënd, një anëtar të stafit të qendrës së pritjes ose një shokut tënd) t'i hedhë një sy CV-së tënde për të qenë i sigurt se gjithçka është e qartë.

Letra shoqëruese:

Ndonjëherë, përveç CV-së, mund të kërkohej t'i bashkëngjitesh aplikimit një letër shoqëruese. Letra shoqëruese i shpjegon punëdhënësit pse ai duhet të të zgjedhë ty dhe jo një tjetër. Për këtë arsye, është e rëndësishme të shkruash qartë motivimet, qëllimet dhe cilësitë që të bëjnë ty njeriun ideal për këtë punë.

Intervista:

Nëse përzgjidhet aplikimi yt, do të të kërkohet të paraqitesh në një intervistë pune, e cila është një takim gjatë të cilit do të diskutosh aftësitë dhe motivimet e tua me punëdhënësin tënd të mundshëm.

Periudha e provës:

disa kompani mund të të kërkojnë të bësh një periudhë prove përpara se të konfirmohet punësimi yt dhe të nënshkruhet kontrata e punës. Gjatë kësaj periudhe fillestare është e rëndësishme të shfaqësh të gjitha cilësitë që ke për të kaluar provën. Mundohu të jesh bashkëpunues me kolegët e tu të rinj, bëj pyetje dhe trego që je i besueshëm dhe i motivuar.



9. TË DREJTAT E PUNËTORËVE

Çdo punëtor ka të drejta dhe përgjegjësi. Punëtorët e huaj konsiderohen të barabartë me shtetasit italianë për përmbushjen e të drejtave specifike të punës.

Cilat janë të drejtat e mia kur filloj të punoj?



Ju lutemi, vini re: disa nga këto të drejta (të tilla si pushimet, sëmundja dhe lëndimi) mund të ndryshojnë në varësi të llojit të kontratës ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit.

PAGA

Ti ke të drejtën të paguhesh “në një shumë që është në përpjesëtim me sasinë dhe cilësinë e punës tënde dhe në çdo rast të mjaftueshme për të siguruar një jetesë të lirë dhe të denjë” (Neni 36 i Kushtetutës).

Ju lutemi, vini re: të miturve duhet t’u garantohej paga e njëjtë me të rriturit për punë të barabartë (neni. 37 i Kushtetutës).

SIGURIA NË PUNË

Punëdhënësi duhet “të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur shëndetin dhe integritetin tënd psikofizik” dhe të respektojë rregullat e sigurisë në punë (Neni 2087 i Kodit Civil).

Ju lutemi, vini re: të miturit nuk mund të përfshihen në aktivitete që dëmtojnë zhvillimin e tyre psiko-fizik (p.sh: pirja e alkoolit dhe përdorimi i makinerive të rënda ose substancave të dëmshme). Të miturit nuk mund të transportojnë pesha për më shumë se 4 orë rresht në ditë.

ORËT E PUNËS

Orët zyrtare të punës janë **40 orë në javë**. Orët shtesë konsiderohen **jashtë orarit dhe paguhen më shumë**. Në çdo rast, orari javor nuk mund të kalojë kurrë **48 orë** (Ligji 196/1997).

Ju lutemi, vini re: të miturit nuk mund të punojnë më shumë se 40 orë në javë, nuk mund të punojnë jashtë orarit ose të punojnë natën.

PUSHIMI JAVOR

Ke të drejtën për **një ditë pushimi çdo javë**, e cila zakonisht bie të dielën (Neni 2109 i Kodit Civil).

Ju lutemi vini re: të miturit kanë të drejtë për të paktën dy ditë pushim në javë, mundësisht të njëpasnjëshme dhe duke përfshirë të dielën.

PUSHIMET, SËMUNDJET DHE LËNDIMET

Ke të drejtën për pushime të paguara **të paktën 4 javë në vit** (Neni 2109 Kodi Civil) dhe ditë pushimi të paguara **në rast sëmundjeje**. Në rast lëndimi, punëdhënësi paguan për 4 ditët e para dhe INAIL paguan për ditët në vijim (Neni 2110 i Kodit Civil).

TË DREJTAT E SINDIKATAVE

Ke të drejtën të **anëtarësohesh në një sindikatë** për të mbrojtur të drejtat themelore të punëtorëve. Sindikata të përfaqëson, duke mbrojtur interesat e tua brenda vendit të punës.

GREVA

Ke të drejtën për të bërë grevë, e cila është **mungesë kolektive në punë**. Do të thotë të mos shkosh në punë për të demonstruar dhe rritur ndërgjegjësimin për kushtet e punës dhe interesat e punëtorëve. Orët e grevës nuk paguhen (Ligji 146/1990).

STUDIMI DHE PUNA

Nëse punon dhe studion, ke të drejtën për turne pune që përshtaten me orët e mësimin dhe me përgatitjen e provimeve (Ligji 300/1970).

LEJA E LINDJES PËR NËNËN DHE BABANË

Nëse je shtatzënë, **nuk mund të pushohesh nga puna që nga fillimi i shtatzënisë deri në një vit pas lindjes së foshnjës**. Ke të drejtën për **leje lindjeje** (një periudhë e paguar për mungesë të detyrueshme në punë). Prindërit kanë të drejtë për një **periudhë fakultative mosshkuarje në punë për t'u kujdesur për fëmijët**.

TRAJTIMI I BARABARTË I BURRAVE DHE GRAVE

Gratë kanë të drejta të barabarta si të gjithë punëtorët e tjerë dhe **nuk lejohet asnjë formë diskriminimi në bazë të gjinisë** (Neni 37 i Kushtetutës).

10. RREZIQET E PUNËS PA KONTRATË



Kujdes nga puna pa kontratë!!!

Ndonjëherë quhet edhe punësim i **padeklaruar**, në të zezë ose i parregullt. Kjo është një marrëdhënie pune pa kontratë, ku punëdhënësi nuk ka njoftuar Centro per l'impiego për punësimin e punëmarrësit. Puna e padeklaruar nuk ofron asnjë garanci për sigurimet shoqërore ose shëndetësore.

- Kjo do të thotë që **nëse punon në mënyrë të paligjshme, nuk të garantohen të drejtat për të cilat sapo lexove!**
- Kjo do të thotë se puna e padeklaruar **shpesh është sinonim i shfrytëzimit, cënimit të të drejtave dhe disa herë madje edhe i rrezikut për veten.**

Për shkak të **natyrës së paligjshme**, punëdhënësit i vendosen gjoba.

!!! Nëse beson se je në një cikël punësimi të paligjshëm dhe dëshiron të dalësh prej tij (ose njeh dikë tjetër në këtë situatë), bisedo me një person tek i cili ke besim dhe kontakto shoqatat për përkrahjen e punëtorëve.

Për të **denoncuar punën e padeklaruar dhe shfrytëzimin në punë**, mund të shkosh në zyrë të ndryshme, për shembull, mund të kërkosht degën më të afërt të organeve të mëposhtme:

- **Ispettorato del Lavoro** (Inspektorati i Punës): <https://www.ispettorato.gov.it/>
- **La Guardia di Finanza**: <https://www.gdf.gov.it/>
- **Një sindikatë**: për shembull, CGIL (*Confederazione generale italiana del lavoro-Konfederata e përgjithshme italiane e punës*), CISL (*Confederazione italiana sindacati lavoratori-Konfederata italiane e sindikatave të punëtorëve*), UIL (*Unione italiana del lavoro-Unioni italian i punës*) dhe UGL (*Unione generale del lavoro-Unioni i përgjithshëm i punës*).

11. PARIMI I MUNDËSIVE TË BARABARTA DHE MOSDISKRIMINIMIT

Askush nuk mund të të trajtojë ndryshe sepse vjen nga një vend tjetër, në punë apo në jetën tënde të përditshme.

Në Itali, **ndalohet çdo formë diskriminimi në punësim** për shkak të moshës, kombësisë, fesë, gjuhës, gjinisë, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, opinioneve politike ose personale, përkatësisë në një pakicë etnike, kushteve sociale ose ekonomike, anëtarësisë ose joanëtarësisë në një sindikatë etj.



Çfarë mund të bëj nëse jam viktimë e diskriminimit?

Ka disa gjëra që mund të bësh nëse je viktimë ose dëshmitar i diskriminimit. Së pari, **mund ta çosh çështjen në gjykatë ose të kontaktosh shoqatat që punojnë për të mbrojtur të drejtat e tua.**

Më poshtë janë disa burime të tjera informacioni dhe subjekte që mund të kontaktosh.

Në Itali, ka organizata të ndryshme kombëtare që mbrojnë njerëzit nga format e diskriminimit dhe numra pa pagesë për të kontaktuar në rast nevojë.



UNAR – Zyra Kombëtare italiane kundër diskriminimit racor, Ufficio Nazionale Antidiscriminazioni Razziali: www.unar.it



Ky është departamenti i caktuar nga shteti për të siguruar të drejtën për trajtim të barabartë dhe çrrënjosjen e diskriminimit për shkak të racës ose origjinës etnike.

 **800.90.10.10**

Numri kundër Dhunës dhe Përndjekjes: www.1522.eu

1522 NUMERO
ANTI VIOLENZA
E STALKING

Ky është një shërbim falas i disponueshëm 24 orë në ditë, i cili ka operatorë të specializuar që trajtojnë kërkesat për ndihmë dhe mbështetje nga viktimat e dhunës dhe përndjekjes.

 **1522**

Telefono Azzurro (Telefoni i kaltër): www.azzurro.it



Kjo organizatë promovon të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentëve dhe i mbron ata nga abuzimi dhe dhuna që mund të dëmtojë mirëqenien dhe zhvillimin e tyre.

 **1.96.96**

Autoriteti italian për mbrojtjen e fëmijëve dhe adoleshentëve- Autorità garante dell'infanzia e dell'adolescenza: www.garanteinfanzia.org



Kjo organizatë në Itali promovon dhe verifikon zbatimin e plotë të të drejtave të fëmijëve të parashikuara nga Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës të vitit 1989.

A ke nevojë të flasësh me një ekspert? Kontakto HERE4U!



Here4U ofron këshillim psikosocial për të miturit e huaj të pashoqëruar dhe të rinjtë imigrantë dhe refugjatë. Ky shërbim funksionon përmes **platformës U-Report on the Move** nga UNICEF-i në bashkëpunim me ARCI-n.

- Është shërbim **online dhe shumëgjuhësh**
- Është në dispozicion **nga e hëna deri të premten nga ora 9:00 deri në orën 18:00**
- Thjesht dërgo një mesazh **Facebook Messenger -Whatsapp - Telegram** në faqen **U-Report On The Move**   

Është **hapësirë e sigurt dëgjimi** ku **mund të flasësh për vështirësitë dhe mendimet e tua dhe të kërkesësh ndihmë**. Një ekip ekspertësh ligjorë dhe psikosocialë do të të ndihmojnë duke ofruar mbështetje të personalizuar sipas nevojave tuaja, me ndihmën e ndërmjetësuesit gjuhësor-kulturor.

U-Report On The Move: <https://onthemove.ureport.in/join/>

12. FAQET E INTERNETIT PËR INFORMACIONE TË MËTEJSHME

- **Ministero del Lavoro e delle Politiche Sociali** (Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale): <http://www.lavoro.gov.it/>
- **Clic Lavoro**, një faqe e mbështetur nga *Ministero del Lavoro e delle Politiche Sociali* ku mund të gjesh lajme dhe informacione të dobishme rreth punës dhe kurseve të trajnimit: <https://www.cliclavoro.gov.it/>
- **Scuola in Chiaro**, faqja e internetit e Ministrisë së Arsimit, të jep mundësinë të kërkosh shkollat më të afërta, duke përfshirë CPIA-të dhe *Centri di Formazione Professionale* (qendrat e formimit profesional): <https://cercalatuascuola.istruzione.it/cercalatuascuola/>
- **Lista e bursave universitare për përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare ose të përkohshme në faqen e internetit të Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale:** <https://integrazioneimmigranti.gov.it/it-it/Dettaglio-approfondimento/id/36/Borse-di-studio-universitarie-per-beneficiari-di-protezione-internazionale-o-temporanea>
- **Cerca sportello në faqen e internetit të Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale:** <https://servizi.lavoro.gov.it/cerca-sportello/>
- **Informagiovani + emri i qytetit ku jeton:** në faqen e internetit Informagiovani të qytetit ku jeton mund të gjesh informacione për trajnimin, vullnetarizmin, mundësitë e punësimit dhe aktivitetet e kohës së lirë në zonën ku banon
- **Portali “Integrazione Migranti”:** <https://integrazioneimmigranti.gov.it/it-it/>

- **Excelsior**, një sistem informacioni për punësimin dhe informacionin e ofruar nga Unioni Italian i Dhomave të Tregtisë dhe ANPAL. Këtu mund të gjejsh të dhëna të përditësuara për profesionet më të kërkuara dhe industritë që kanë më shumë vështirësi për të gjetur personel: <https://excelsior.unioncamere.net/>
- **INAIL**, *Istituto Nazionale Assicurazione Infortuni sul Lavoro* (Instituti Italian i Sigurimeve për Aksidentet në Punë): www.inail.it
- **INPS**, *Istituto Nazionale Previdenza Sociale* (Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore). Shko nga “Home” → “Categorie di Utenza” → “Lavoratori migranti”. Mund të gjejsh informacione për të drejtat e tua, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore: www.inps.it
- **Ispettorato del Lavoro** (Inspektorati i Punës): <https://www.ispettorato.gov.it/>
- **Juma Map**, hartë mbarëkombëtare e shërbimeve për azilkërkuesit dhe përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare, e disponueshme në 15 gjuhë: <https://www.jumamap.it/>
- **U-Report on the Move**: një mjet mesazhesh anonim dhe falas (në Facebook, Instagram dhe Telegram) i cili ofron informacione shumëgjuhëshe për shërbimet e dobishme për të miturit e huaj të pashoqëruar dhe të rinjtë imigrantë dhe refugjatë në Itali. Mund të shprehësh mendimin tënd përmes anketave dhe të marrësh pjesë në ngjarje dhe aktivitete shoqërore dhe zbavitëse: <https://onthemove.ureport.in/>

SHTOJCA 1

CURRICULUM VITAE “EUROPASS”



Si të plotësosh Curriculum Vitae në formatin Europass

HISTORIKU I PUNËS

- Përqendrohu te pozicionet e punës që i japin vlerë të shtuar aplikimit tënd.
- Vendos fusha të veçanta për secilin pozicion. Filllo nga ai më i fundit.
- Nëse ke përvojë profesionale të paktë:
 - Filllo duke renditur arsimimin dhe trajnimin profesional;
 - Përmend punën vullnetare ose praktikat (qoftë të paguara apo jo) që tregojnë përvojën tënde të punës.
- Nëse nuk ke përvojë të mëparshme specifike profesionale për pozicionin për të cilin po aplikon, thekso aftësitë që ke fituar në kontekste të tjera që janë të rëndësishme për atë pozicion. Për shembull, nëse po aplikon për një rol menaxherial, por nuk ke punuar kurrë më parë si menaxher, thekso se pozicioni yt i mëparshëm përfshinte përgjegjësi të rëndësishme dhe detyra vendimtare (delegim, koordinim, trajnim personeli, etj.).

Zëvendëso me datat (nga-deri në)

Shembull:

shtator 2007 - sot

Zëvendëso me pozicionin e punës

Shembuj:

Teknik i mirëmbajtjes/ Receptionist/ Trajner Vullnetar i Hoqejit në Akull

Zëvendëso me emrin dhe vendndodhjen e punëdhënësit (nëse është e përshtatshme, shto adresën e plotë dhe faqen e internetit)

Shembull:

Alma Mater Studiorum, Via Zamboni 37, 40126 Bologna

Jep vetëm telefon, faks, email ose adresë interneti nëse kërkohet.

Tel.: +39 339 372 5000 - Email: info@almamater.com
- <http://www.almamater.com>

Zëvendëso me detyrat kryesore

Shembuj:

- Mirëmbajtje kompjuterësh
- Marrëdhënie me furnitorët
- Stërvitja e ekipit të të rinjve të hokejit mbi akull (10 orë/javë)

Nëse është e nevojshme, llogarit përgjegjësitë e tua (përqindja e kohës së punës, kohëzgjatja e detyrave individuale, etj.).

Biznesi ose sektori: Zëvendëso me llojin e kompanisë ose sektorit

Përdore këtë hapësirë vetëm nëse kërkohet.

Shembuj:

Kompania ose sektori: Transport dhe logjistikë / Auditim/ Prodhues i pjesëve të automjeteve

ARSIMI DHE TRAJNIMI

Zëvendëso me datat (nga - deri në)

Shembull:

shtator 2004 - qershor 2007

Fut shënime të veçanta për çdo kurs. Fillo me ata më të fundit.

Zëvendëso me datat (nga - deri në). Zëvendëso me kualifikimet e fituara

Certifikimi i operatorit profesional: Bukëpjekës

Mos përdor vetëm shkurtesa (AQOP).

Zëvendëso me emrin dhe vendndodhjen e institucionit arsimor ose trajnimit (nëse është e rëndësishme shkruaj edhe shtetin)

Shembuj:

Centro di Formazione Professionale Guglielmo Marconi, Bologna

Zëvendëso me listën e lëndëve kryesore të studiuara ose të aftësive të fituara.

Shembuj:

Të përgjithshme

- Anglisht, gjuha e Uellsit, Matematikë, Spanjisht
- Edukim fizik

Profesionale

- Teknikë profesionale (bukë standarde, bukë e veçantë, tortë dhe ëmbëlsira)
- Shkenca dhe Teknologji të Aplikuara Ushqimore (Mikrobiologji, Biokimi, Higjienë)
- Teknologjia në punë (parimet bazë, higjiena dhe siguria)
- Njohuri për sektorin dhe kontekstin e tij financiar, ligjor dhe social

Përqendrohu në ato aftësi profesionale që do të ishin pasuri për kompaninë nëse punësohesh aty

AFTËSI PERSONALE

Gjuha/gjuhët amtare

Hiq çdo fushë që ka mbetur bosh.

Gjuha amtare zëvendësohet me gjuhën amtare përkatëse

Shembull:

Italisht

Mos e mbivlerëso nivelin tënd, i cili do të testohet në intervistë!

Gjuhë të tjera

TË KUPTUARIT - TË FOLURIT - TË SHKRUARIT

Të dëgjuarit - Të lexuarit - Ndërveprimi - Të folurit

Shembull:

C1

Shembull

B2:

Zëvendëso gjuhën

Shembull:

Anglisht

Zëvendëso me certifikatat që ke marrë për gjuhët.

Vendos nivelin e gjuhës, nëse e di.

Shembull:

Certificado de Español: Lengua y Uso

Nivelet: A1/2: fillestar - B1/2 i ndërmjetëm - C1/2 i avancuar

Kuadri Evropian i Përbashkët i Referencave për Gjuhët

Kur përshkruan aftësitë e tua personale:

- Përdor fjalë të qarta, të thjeshta me gjuhë të drejtpërdrejtë.

- Mos përdor zhargon dhe klishe (për shembull: punoj në ekip) pa dhënë kontekstin në të cilin kjo mund të zbatohet për një aftësi ose arritje.
- Ji konciz: mendoje mirë cilat aftësi janë të rëndësishme për pozicionin për të cilin po aplikon
- Specifikë si i ke marrë këto aftësi (përmes trajnimeve, punës, seminareve, vullnetarizmit apo aktiviteteve të kryera në kohën tënde të lirë, etj.).

Aftësitë komunikuese

Shkruaj aftësitë e tua të komunikimit këtu.

Trego kontekstin në të cilin janë marrë

Shembuj:

- aftësi të mira komunikimi të fituara gjatë kohës që kam kaluar si drejtues i shitjeve
- aftësi të shkëlqyera ndërpersonale me fëmijët të fituara gjatë përvojës time vullnetare si trajner hokey mbi akull

Aftësitë menaxhuese dhe organizative

Vendosi aftësitë e tua menaxhuese dhe organizative këtu.

Trego kontekstin në të cilin janë marrë.

Shembuj:

- udhëheqje (aktualisht përgjegjës për një ekip prej 10 personash)
- aftësi të mira organizative të fituara gjatë përvojës sime të punës si sekretar/e në Shoqatën e Historisë. Përgjegjës për programimin e folësve dhe promovimin e aktiviteteve
- aftësi të mira drejtuese të ekipit të fituara gjatë përvojës sime vullnetare si trajner hokey mbi akull

Aftësitë profesionale

Vendos këtu aftësitë e tua profesionale që nuk janë treguar diku tjetër. Jep kontekstin ku i keni fituar këto aftësi.

Shembuj:

- zotërim i mirë i proceseve të kontrollit të cilësisë (aktualisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë)
- aftësi mentorimi (si infermier/e i/e vjetër, unë isha përgjegjës/e për trajnimin dhe organizimin e anëtarëve të rinj të personelit të infermierëve)

Përpunimi i informacionit

Shembull:

Përdorues bazë

Komunikimi

Shembull:

Përdorues i ndërmjetëm

Krijimi i përmbajtjeve

Shembull :

Përdorues i ndërmjetëm

Siguria

Shembull:

Përdorues i avancuar

Zgjidhja e problemeve

Shembull:

Përdorues i avancuar

Nivelet: Përdorues bazë - Përdorues i ndërmjetëm -

Përdorues i avancuar

Aftësitë kompjuterike - Fletë vetëvlerësimi

Vendos emrin e certifikatës tënde për TIK.

Shembull:

Statusi i certifikatës: Office suite - Përdorues i pavarur

Vendos këtu çdo aftësi tjetër kompjuterike. Tregoni kontekstin ku i keni fituar këto aftësi.

Shembuj:

- zotërim i mirë i “Office Suite” (përpunim teksti, fletë-llogaritjeje, softuer prezantimi)
- zotërim i mirë i softuerit të përpunimit të imazhit digjital si fotograf amator

Aftësi të tjera

Vendos këtu çdo aftësi tjetër tënden. Trego kontekstin në të cilin janë marrë.

Plotëso këtë fushë vetëm nëse aftësitë e përshkruara i shtojnë vlerë aplikimit tënd dhe nuk i ke përmendur askund më lart. Trego kontekstin në të cilin janë marrë.

Shembull:

- ndihma e parë: certifikatë për ndihmën e parë si pjesë e trajnimit tim si zhytës

Interesat personale si leximi, ecja, shkuarja në kinema etj. nuk kanë asnjë vlerë të shtuar. Nga ana tjetër, dhënia e shembujve të aktiviteteve në të cilat ke marrë pjesë mund të jetë një mjet i dobishëm, për shembull për të treguar se je person proaktiv, social që pëlqen të ndihmojë të tjerët:

- leximi: kam pasion leximin, ndihmoj nxënësit e vegjël me leximin e tyre dy herë në javë
- alpinizëm: alpinist ekspert, anëtar aktiv i një klubi alpinist vendor

Leja e drejtimit të mjetit

Vendos këtu kategorinë e lejes së drejtimit.

Shembuj:

B

SHTOJCA 2

TANI ËSHTË RADHA JOTE!



Plotëso këtë pyetësor për të zbuluar se sa shumë ke mësuar me këtë Manual. Në fund do të gjesh përgjigjet e sakta.

PYETJET	PËRGJIGJET
1. Pse është i dobishëm orientimi profesional? <i>Zgjidh një ose disa përgjigje.</i>	☐ a. Më ndihmon të vlerësoj njohuritë e mia dhe të mësoj aftësi të reja që do të më ndihmojnë të gjej punë ☐ b. Nuk është i nevojshëm nëse tashmë e di se çfarë pune dua të bëj ☐ c. Më udhëzon për rrugët e ndryshme të trajnimit që mund të më ndihmojnë të hyj në botën e punës ☐ d. Më ndihmon të vendos për një objektiv profesional dhe të kuptoj se si mund ta arrij atë
2. Arsimi në Itali është një e drejtë por edhe një detyrim.	☐ a. E vërtetë ☐ b. E gabuar
3. Cila është mosha minimale ligjore për të filluar punë në Itali?	☐ a. 14 vjeç ☐ b. 15 vjeç ☐ c. 16 vjeç ☐ d. 18 vjeç
4. Nëse zgjedh të përfundosh Istruzione e Formazione Professionale trevjeçare ose ATP (Kurs të Arsimit dhe Trajnimit Profesional), çfarë kualifikimi merr në fund?	☐ a. <i>Qualifica professionale</i> ☐ b. <i>Diploma professionale</i>
5. Një praktikë është “jashtëshkollore” kur zhvillohet pasi të ketë përfunduar një kurs studimi.	☐ a. E vërtetë ☐ b. E gabuar
6. Kur të jepet borsa lavoro (“bursë pune”), hyn në përvojën e punës dhe paguhesh:	☐ a. Nga kompania ☐ b. Nga promotori (Rajoni, Provinca, Bashkia, etj.)

7. Një praktikë pune është një kontratë pune e karakterizuar nga theksi i saj te trajnimi.	☐ a. E vërtetë ☐ b. E gabuar
8. Cilat janë kërkesat për të aplikuar për shërbimin civil? <i>Zgjidh një ose disa përgjigje.</i>	☐ a. Vetëm qytetarët italianë mund të aplikojnë ☐ b. Më nevojitet leje qëndrimi e vlefshme ☐ c. Nuk duhet të kem precedentë penale ☐ d. Duhet të jem midis moshës 16 dhe 22 vjeç ☐ e. Duhet të jem midis moshës 18 dhe 28 vjeç
9. Çfarë është një <i>attestato</i> di HACCP (çertifikata HACCP)?	☐ a. Një çertifikatë e detyrueshme për këdo që dëshiron të bëhet ndërmjetësues kulturor ☐ b. Një çertifikatë e detyrueshme për këdo që dëshiron të punojë në sektorin e ushqimit
10. Çfarë është një OSS?	☐ a. Një ofrues i kujdesit shëndetësor dhe social që ofron kujdes dhe mbështetje për njerëzit që nuk janë në gjendje të jetojnë të pavarur ☐ b. Një operator në sistemin e pritjes
11. Për të hyrë në botën e punës në Itali, kërkohet të flasësh mirë italisht.	☐ a. E vërtetë, kërkohet ☐ b. E gabuar, nuk kërkohet, por është shumë e rëndësishme
12. Për çfarë shërben <i>Dichiarazione di Immediata Disponibilità al lavoro</i> ose DID (Deklarata e Gatishmërisë së menjëhershme për punë)?	☐ a. Është një mënyrë për të deklaruar se jam duke kërkuar punë dhe jam i gatshëm menjëherë ☐ b. Kërkohet për të marrë një Licenza Media ☐ c. Kërkohet për të marrë kodin fiskal
13. <i>Piano Educativo Individualizzato</i> ose PEI (Plani Arsimit Individualizuar) është dokument që përdoret për të vendosur objektivat e kursit të trajnimit që po ndjek, bazuar në nevojat e tua specifike.	☐ a. E vërtetë ☐ b. E gabuar

14. Çfarë janë aftësitë e tërthorta?	☐ a. Aftësitë bazë si leximi dhe shkrimi ☐ b. Aftësi teknike specifike për profesione të caktuara ☐ c. Aftësi dhe kapacitete sociale dhe emocionale që janë të dobishme në të gjitha fushat e punës
15. Pse është i rëndësishëm vlerësimi i aftësive?	☐ a. Më lejon të vlerësoj atë që di tashmë ☐ b. Më ndihmon të kuptoj se cilat aftësi duhet të fitoj ose përmirësoj ☐ c. Të dyja përgjigjet janë të sakta
16. Nëse merr pjesë në një grevë në punë, punëdhënësi mund të të pushojë nga puna.	☐ a. E vërtetë ☐ b. E gabuar
17. A mund të punosh dhe studiosh njëkohësisht?	☐ a. Jo, po fillove punë nuk mund të studiosh më ☐ b. Po, çdo punëtor që studion gjithashtu ka të drejtë për turne që janë në përputhje me oraret e mësimi dhe provimet e tij
18. Në Itali, çdo formë diskriminimi në punë është e paligjshme dhe viktimat e diskriminimit mund ta çojnë çështjen e tyre në gjykatë.	☐ a. E vërtetë ☐ b. E gabuar

Dhe tani kemi një pyetje të fundit për ty!

Në një shkallë nga 1 në 5, sa i dobishëm t'u duk ky Manual për orientimin tënd profesional?

1	2	3	4	5
				

PËRGJIGJET E SAKTA

1.	a. - c. - d.
2.	a.
3.	c.
4.	a.
5.	a.
6.	b.
7.	a.
8.	b. - c. - e.
9.	b.
10.	a.
11.	b.
12.	a.
13.	a.
14.	c.
15.	c.
16.	b.
17.	b.
18.	a.



SHËNIME



A series of horizontal lines for writing, spanning the width of the page below the title.











**Finanziato
dall'Unione Europea**

UNICEF Europe and Central Asia
Regional Office - Italy Outpost
Via Palestro 68, 00185 Rome Italy
Telephone: +39.06.478091
www.unicef.org/eca/

©UNICEF, 2024

